



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-400/01-0031545-1/25 dt. 11.06.2025
Mitrovicë

PROCES VERBAL
NGA KONSULTIMI PUBLIK PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE
2026-2028

Koha: 11.06.2025 ora 14:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Igballe Islami: Bashkë me mua sot është edhe sekretari i Kuvendit, zoti Nazmi Jashari, ndërsa kryesuesja e Kuvendit, për arsye subjektive nuk mundet sot me marrë pjesë bashkë me ne. Drejtorja për Buxhet e Financa në bashkëpunim me Kryesuesen e Kuvendit ka thirrur sot këtë dëgjim publik, pasi që ne kemi pranuar edhe Qarkoren e parë buxhetore 2026/01, sa i përket ndarjes së buxhetit të komunës, domethënë ndarjes së granteve. Ne bashkë me Kryetarin e Komunës dhe drejtoritë komunale kemi bërë edhe shpërndarjen e buxhetit në kategoritë ekonomike ndërsa për t'u konsultuar edhe me publikun e gjerë është thirrur sot ky konsultim publik. Sa i përket qarkores së parë buxhetore, vlen të potencohet fillimisht fakti që Komunës së Mitrovicës i është ndarë buxheti me përqindje më të vogël, për arsye të uljes së numrit të banorëve, tash ne d.m.th tash kemi kalkulua numrin e banorëve me rreth 64.000 banorë, bazuar në raportin e fundit të Agjencionit të Statistikave të Kosovës e që pa dyshim ka ndikua edhe në financimin total të buxhetit. Komuna e Mitrovicës në vitin aktual 2025 ka pasur buxhet në vlerë 30.240.000,00 € ndërsa për vitin 2026, bazuar në Qarkoren Buxhetore dhe bazuar në Komisionin për Ndarjen e Granteve, në nivel vendi i komunës së Mitrovicës janë ndarë 32.480.000,00 €, kjo është një rritje prej 6%, nëse e marrim si përqindje totale të financimit, ndërsa nëse shkojmë nëpër grande, sepse neve me qarkoren e parë, neve na vijnë vetëm grantet edhe kemi grantin e përgjithshëm, ku kemi pasur një rritje prej 10%, 6% në grantet specifike për arsim 0% në shëndetësi rritje, ndërsa financimi për teatron 19%, që bie 6%.

Duhet me pa të arsyeshme që buxheti do të ndahet nëpër kategori ekonomike, duke i marrë për bazë obligimet kontraktuale dhe obligimet financiare, që ka edhe burojnë në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, gjithashtu duke i marrë edhe kërkesat prej dëgjimeve buxhetore, të cilat ne do t'i organizojmë në vazhdimësi. Andaj, me qëllim të gjithë përfshirjes edhe të qytetarëve, edhe grupeve tjera të interesit në planifikimin buxhetor, ne e kemi thirrur edhe këtë dëgjimin të parë buxhetor mirëpo më lejoni t'ju njoftoj edhe një herë që ne fillimisht e kemi ndarë buxhetin vetëm në kategori ekonomike ndërsa shpërndarja nëpër drejtoritë komunale do të bëhet gjatë dëgjimeve buxhetore, të cilat do të organizohen në muajt korrik dhe gusht domethënë deri kur e kemi afatin sipas legjislacionit në fuqi për me procedua në asamblenë komunale dhe aty do t'i marrim kërkesa për projektet edhe për çështje të cilat janë në interes tuaj edhe komunitetet edhe lokalitetet ku ju e përfaqësoni, kështu që Kornizën afatmesme buxhetore e kemi proceduar edhe për aprovim në seancën e ardhshme të Kuvendit Komunal që do të mbahet, e kemi ligjërisht obligim që deri më 30 qershor të votohet korniza afatmesme buxhetore ndërsa pasi që i kemi pranua grantet, ne kemi bërë edhe ndarjen e buxhetit në kategoritë ekonomike. Andaj, po ju lexoj shkurtimisht qysh ne kemi planifikua që buxheti i vitit 2026 me u pasqyrua. Paga dhe mëditja

janë të planifikuara 19.1 milion €, në mallra dhe shërbime 4.8 milion € shpenzime komunale 600.000€, në subvencione dhe transfere 1.2 milionë € dhe pjesa tjetër prej 6.6 milionë € do të shkojnë në investimet kapitalc. Unë po e potencoj edhe një herë që buxheti, Korniza afatmesme buxhetore votohet vetëm në kufijtë d.m.th, vetëm në kategori ekonomike, nuk ndahet në projekte, nuk ndahet në drejtori, kështu që kjo është vetëm një përfshirje edhe është kjo domethënë planifikimi fillestar i buxhetit. Në Dëgjimet tjera do t'i marrim edhe kërkesat sa i përket edhe projekteve dhe kërkesave tjera dhe bazuar në ato kërkesa, ku ju i përfaqësoni edhe prej lokaliteteve diçka tjetër nuk kam me shtu, mbetemi të hapur edhe për diskutime. Ata të cilët dëshirojnë me marrë fjalën, vetëm të prezantohen fillimisht për shkak të procesverbalit, ndërsa në të njëjtën kohë mundeni edhe të gjitha kërkesat e juaja me i adresua në zyrën e Sekretarisë së Kuvendit në e-mailin: nazmi.jashari@rks-gov.net ose edhe drejtpërdrejt në Zyrën Pritëse dhe në Zyrën numër 60 sekretarisë së Kuvendit të Komunës. Pra sot Sekretaria e Kuvendit ka pranuar nga Asambleja e Fëmijëve kërkesat e tyre të cilat do të përfshihen në procesverbalin, i cili do t'i dorëzohet për shqyrtim edhe KPF-së po ashtu edhe kuvendit të komunës.

Atëherë po e hapim për diskutim por po e ceku edhe një herë që gjithsesi që kërkesat e juaja mundeni me i adresua edhe në formë të shkruar.

Xhenis Beqiri: Menaxher në Shoqatën Doun Sindrom Kosova. Çfarë mbetet shqetësuese për mos të kaloj në vitin 2026 nga viti 2025, komuna ende nuk i kanë ndarë mjetet dhe nuk kanë hapur thirrje për shërbime sociale për personat me aftësi të kufizuara, që është çështje imediate, sepse ka shkuar gjysma e vitit 2025 dhe ende nuk është kthyer vëmendja për gjendjen e personave me aftësi të kufizuara, përse komuna nuk ofron shërbime sociale për qytetarët rezidentë të komunës së tyre. Unë kisha dashur të di, por besoj që buxheti është ndarë në vitin 2024 për këtë vit dhe për mos t'u kaluar në vitin 2026, dhe kisha dashur të di nëse do të rritet buxheti në drejtorinë e mirëqenies sociale apo do të minimaliste edhe pse ju e dini, Plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara është miratuar nga kjo Asamble dhe është paraparë një buxhet për vitet 2025- 2026 dhe 2027, prej 100.000 € në vit

Igballe Islami: Unë po të falënderoj shumë për punën dhe përkushtimin që ke. Unë po të njoftoj se buxheti i drejtorisë për Mirëqenie Sociale nuk është minimalist. Buxheti i drejtorisë për Mirëqenie Sociale, për kategorinë e subvencioneve, arrin vlerën prej 400.000 €. Me këtë fillim vit, besoj se janë ndarë subvencione bazuar në planifikimin që ka bërë Drejtoria për subvencionimin e familjeve me asistencë sociale. Unë mendoj se Komuna e Mitrovicës ka bërë hapa konkretë sa i përket socializimit dhe integritit të personave me aftësi të kufizuara ku ka edhe praktikë të pagesës për këtë kategori. Jemi ndër komunat e pakta që ofrojmë këto shërbime për vitin e dytë dhe të tretë radhazi. Sa i përket thirrjeve publike, mund ta marr kërkesën tuaj dhe ta adresoj te Drejtoria sepse buxheti dhe financat janë në dispozicion. Mbetet te drejtoresha të iniciojë thirrjen dhe të kryej procedurat tjera, sepse sa i përket buxhetit, ka mjete të mjaftueshme dhe besoj se është vetëm çështje kohe që të procedohet thirrja.

Xhenis Beqiri: Në përgjigje të pyetjes suaj drejtoresh, në email zyrtar nuk kemi marrë përgjigje, por gojarisht zyrtarët e Mirëqenies Sociale kanë thënë se thirrja publike është dorëzuar në zyrën e Kryetarit, por është rikthyer në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, pse është kthyer nuk dihet, por do të ishte mirë që organizatat që merren me personat me aftësi të kufizuara të merrnin përgjigje, sepse gjashtë muajt e parë të vitit kaluan dhe personat me aftësi të kufizuara nuk kanë përfituar asnjë shërbim nga komuna ku janë rezidentë. Kjo mbetet shqetësuese, sepse nuk janë marrë hapat në fillim të vitit për shpalljen e thirrjes publike dhe ofrimin e shërbimeve sociale për këtë grup qytetarësh.

Igballe Islami: Për këtë arsye, unë si përfaqësues e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, përveç planifikimit, edhe në fund kur jemi te ekzekutimi i vendimeve dhe kontratave, do të siguroj që kërkesa juaj do të adresohet te Drejtoria Përgjegjëse dhe Kabineti i Kryetarit.

Vetone Veliu: Nga Organizata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut: Për momentin ne nuk kemi kërkesa, sepse me datën 13 dhe 17 do të mbajmë takime me gra. Nga këto takime, siç ndodh çdo vit tjetër që organizojmë, dalin kërkesat e grave, të cilat ne pastaj ia procedojmë juve, sipas praktikave dhe viteve të kaluara. Ju ftoj të jeni pjesë e këtyre takimeve, pasi është në interesin tuaj dhe të grave të

përfshihen në to. Ju do t'ju informojmë edhe për kohën dhe detajet tjera ndërkohë. Dua t'ju përgëzoj për draftin, nëse mund ta quajmë kështu edhe pse duhet të punohet pak më shumë. Pse e keni përfshirë vleshmërinë gjinore, që dallon nga vitet e tjera? Sa i përket përpilimit, ndoshta është mirë të bëni edhe një herë një kontroll, kini kujdes me indikatorët, sepse nëse nuk ka indikatorë, si do të matet nëse objektivi është arritur apo jo? E njëjta gjë vazhdon për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, ku indikatorët nuk janë mirë të përcaktuar nuk ka përqindje, nuk është vendosur matshmëria, që është shumë e rëndësishme në një dokument të tillë. E njëjta situatë është me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe atë të Bujqësisë, përveç Drejtorisë së Kulturës, e cila ka objektiva më të qarta dhe të shkruara mirë. Ne si shoqëri civile i kemi këto mangësi në punën tonë. Pjesa kryesore e një projekti kur shkruhet duhet të jetë në një nivel të lartë, dhe indikatorët janë shumë të rëndësishëm. Për shembull, është mirë që në draft të shkruhet: "Rritet numri dhe përqindja e grave që marrin pjesë në aktivitetet e Shtëpisë së Kulturës, prej 42% me 1% çdo vit, për të arritur 50%." Kur indikatorët janë të përcaktuar qartë, është më e lehtë të matet suksesi i projektit. Por drejtoritë e tjera nuk kanë asnjë indikator të tillë, prandaj nuk mund të bëhet matje efektive. Ju lutem shqyrtoni sugjerimin tim, përpunojeni dhe gjithashtu punoni edhe në drejtshkrim.

Igballe Islami: Sa i përket implementimit dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, Komuna e Mitrovicës është njëra prej komunave që, në bashkëpunim me ju dhe organizatat e tjera, po punon në këtë drejtim. Pa dyshim, organizata juaj ka një pjesë meritore në këtë proces. Bashkërisht jemi duke punuar për avancimin e kësaj çështjeje. Drejtoria për Shërbime Kulturore ka qenë pjesë e analizës, prandaj ka indikatorë të matshëm dhe është një drejtori e specifikuar mirë. Mirëpo, ne do të vazhdojmë të punojmë sepse Objektivat dhe indikatorët i cakton Drejtoria ndërsa Drejtoria e Financave vetëm i mbledhim dhe i përfshijmë në planifikim. Pa dyshim që edhe këtë vit do të marr pjesë në dëgjimin me buxhetoren dhe gratë, ashtu siç kam bërë edhe vitin e kaluar. Faleminderit për ftesën.

Isak Hajra: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë dua të ju falënderohem për informatat të cilat na i dhatë. Nuk e di sa shpesh në bazë ditore ose në bazë të kërkesave nga njësitë apo kryetarët e këshillave ka pasur koordinim, por nuk e dija nëse ka qenë e mundur një koordinim më i mirë mes strukturave dhe kryetarëve që buxheti dhe kryetarët të kenë një qasje të përbashkët. Për shembull, disa vende apo lokacione kanë mbetur pak mbrapa, ndërsa disa kanë avancuar dhe kanë shkruar më përpara, kjo do të ishte një mundësi që me buxhetim të përfshihen edhe ato vende që kanë ngecur, ndoshta do të ishte mirë që atyre t'u jepet një ftesë më e madhe, që të mos mbeten prapa. Nuk di si është mendimi këtu, por nuk do të ishte keq që edhe kryetarët të kishin njohuri më të mirë dhe buxheti të shkojë edhe në disa vende të caktuara P.sh, disa kryetarë të njëjësive. Në këtë mënyrë, përmes takimeve të koordinuara me kryetarët, mund të arrihej pajtueshmëri me të gjithë sepse janë bërë punë të mëdha, por megjithatë në disa vende kemi pasur ngecje. Në këtë drejtim, në marrëveshjen me ju personalisht, që udhëhiqni buxhetin, ka pasur ide që buxheti të shpërndahej aty ku ka nevojë dhe të merret parasysh më shumë nevoja e vendeve që mbeten pas. Ndoshta kjo që po them unë nuk është zgjidhja përfundimtare, por nëse ka mundësi, duke qenë që edhe kryetarët janë këtu, mund të diskutojmë në të ardhmen për të bërë një buxhet shumë të mirë, të qëlluar dhe me kohë, që të jetë i pranueshëm për të gjithë.

Igballe Ismaili: Vetë thirrja e këtij dëgjimi të parë buxhetor tregon që jeni duke marrë pjesë aktivisht në planifikimin e buxhetit. Unë ju siguroj se do të mbahen edhe dëgjime të tjera buxhetore, ku do të jeni të ftuar përsëri dhe do të keni mundësinë të jepni kërkesat dhe sugjerimet që keni. Kështu, pjesëmarrja juaj në këto dëgjime buxhetore është pjesë e përfshirjes në planifikimin e buxhetit. Ju keni të drejtë të bëni kërkesa për ato lokalitete që i vlerësoni se kanë ngecje në shtrirjen dhe punimet në terren. Për këtë arsye do të mbahen dëgjime buxhetore, ku do të marrim kërkesat dhe do të përpiqemi që çdo pjesë e Mitrovicës të ketë zhvillim dhe punë në terren.

Enes Rama (Kryetari i Asamblesë së fëmijëve): Përshëndetje për të gjithë, unë këtu jam me bashkë kryesinë e asamblesë të fëmijëve. Asambleja komunale është e të rive të një grup nxënësish të moshës rreth 13-14 vjeçarë që përfaqësojnë shkollën e tyre ku vijnë në takimet të cilat i mbajmë diku rreth tri

takimeve në muaj. Kërkesat tona i kemi dorëzuar tek Sekretari i Kuvendit z. Jashari mirëpo këtu edhe njëherë do ti ceku disa pika kryesore:

Emërimi apo punësimi i një zyrtari përgjegjës për të drejtat e fëmijëve në Komunën e Mitrovicës së Jugut, i cili do të na mbështesë në realizimin e aktiviteteve tona dhe zbatimin e planit të punës së Asamblesë së Fëmijëve.

Kërkesat e adresuara nga fëmijët asamblesitë nga shkollat

1. Shkolla "Fazli Grajqevci" – Shipol

- Renovimi i dyerve dhe dritareve të dëmtuara.
- Renovimi i tualeteve dhe nyjeve sanitare në aneksin e shkollës në fshatrat Shipol dhe Vernicë.
- Zgjidhja e problemit të bllokimit të hyrjeve të shkollës nga automjetet e prindërve gjatë sjelljes/marrjes së fëmijëve, përmes krijimit të një hapësire të veçantë për parkim dhe vendosjes së pengesave mbrojtëse. Ky problem vazhdon të paraqesë rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë tonë si fëmijë.

2. Shkolla "Andon Zako Çajupi" – Qytet

- Pajisja e terreneve sportive me mjetet e duhura për edukatë fizike, përfshirë: topa, rrjeta për volejboll, dhe korniza për basketboll.
- Renovimi i sallës së edukatës fizike, e cila aktualisht ka probleme me mykun dhe pluhurin, duke ndikuar negativisht në shëndetin tonë.
- Renovimi i tualeteve dhe nyjeve sanitare për të siguruar kushte higjienike të përshtatshme për fëmijët.
- Investimi në banka dhe karrige të reja, pasi shumë klasa janë të pajisura me mobilie të dëmtuara që ndikojnë në komoditetin dhe cilësinë e të nxënësve.

3. Shkolla "Ismail Qemali"

- Pajisja e kabinetit të informatikës me kompjuterë për zhvillimin cilësor të mësimin praktik në këtë lëndë.
- Riparimi i rrethojës së shkollës për të rritur sigurinë në ambientet e jashtme.
- Renovimi i objektit të shkollës për të përmirësuar ambientin e të nxënësve.
- Hapja e një byfeje për ushqim të sigurt brenda shkollës, pasi objekti ka hapësirë të përshtatshme për këtë qëllim.

4. Shkolla "Bedri Gjinaj"

- Pajisja e kabinetit të informatikës me kompjuterë/laptopë dhe punësimi i një mësimitdhënësi të specializuar për mirëmbajtje dhe asistencë teknike.
- Vendosja e projektorëve apo tabelave smart në klasa për të rritur cilësinë e mësimin.
- Rregullimi dhe pajisja me inventar e kabinetit të Kimisë, përfshirë materialet konkretizuese për mësim (p.sh. fletë, plastelinë etj.).
- Zëvendësimi i bankave dhe karrigeve të dëmtuara për të përmirësuar komoditetin dhe mjedisin e të nxënësve.

5. Shkolla "Nonda Bulku"

- Riparimi ose zëvendësimi i dyerve dhe dritareve të dëmtuara dhe të vjetruara.
- Renovimi i tualeteve dhe nyjeve sanitare.
- Furnizimi i klasave me banka dhe karrige të reja, pasi shumë prej tyre janë të dëmtuara dhe pengojnë përqendrimin në mësim.
- Furnizimi i terreneve sportive me pajisje si: korniza për basketboll, rrjeta për volejboll dhe pajisje të tjera për edukatë fizike.

6. Shkolla "Migjeni"

- Rregullimi i tualeteve dhe nyjeve sanitare për të përmirësuar kushtet higjienike.
- Pajisja e klasave ose të paktën e kabineteve me projektorë për zhvillimin më cilësor të mësimin.
- Pajisja e kabinetit të informatikës me kompjuterë për të konkretizuar njohuritë në praktikë.

Të gjitha kërkesat e paraqitura më sipër janë reflektim i nevojave reale tona si fëmijë/nxënës dhe kanë për qëllim përmirësimin e sigurisë në shkollë dhe afër saj, duke përfshirë edhe kushte më të mira për vajtje-ardhjen në shkollë, cilësinë e mësimin, dhe zhvillimin fizik e social të fëmijëve në komunën tonë. Andaj, duke marrë për bazë edhe zotimin tuaj, i ndërcuar Kryetar i Komunës sonë, Z. Bedri Hamza, që Mitrovica e Jugut është dhe do të jetë një komunë mike për fëmijët, kërkojmë nga ju dhe kabineti juaj që këto propozime të merren parasysh dhe të përfshihen në planifikimet buxhetore për periudhën 2026–2028.

Igballe Islami: Me të vërtetë, më vjen shumë mirë që po ju takoj dhe uroj që të jeni e të mbeteni e ardhunja që përfaqëson Asamblenë e Fëmijëve, por edhe që të na përfaqësoni në Asamblenë Komonale. Ju përgëzoj shumë për ljalimin tuaj, dhe gjithashtu kemi marrë në formë të shkruar të gjitha kërkesat tuaja. Ato që lidhen me Drejtorinë Komonale të Arsimit do t'i diskutojmë sigurisht me drejtoreshën e Arsimit, ndërsa pjesën tjetër, lidhur me angazhimin e një zyrtari për të Drejtat e Fëmijëve, do ta trajtojmë edhe në Bordin e Drejtorëve. Pra, çdo kërkesë nga ana juaj do të shqyrtohet me kujdes, si në mënyrë kolektive, ashtu edhe personalisht me drejtoreshën.

Xhelazim Baliu: Përhëndetje të gjithëve! Dua të pyes për buxhetin e vitit 2023, 2024 dhe 2025 për fshatin Koprivë, A keni ndarë ndonjë buxhet për këtë fshat? Nëse po, a mund të na tregoni se si janë harxhuar këto mjete? Unë jam i sigurt, dhe besoj edhe ju, që nuk është shpenzuar asgjë, por nëse buxheti është ndarë dhe është përdorur, a është e drejtë që ato para të përdoren për qëllime të tjera pa na pyetur neve si banorë? Nëse keni ndarë buxhet për Koprivën, atëherë a keni të drejtë ta përdorni për vende të tjera pa e konsultuar komunitetin? Nëse nuk e keni ndarë, ju lutem na tregoni nëse ka ndonjë plan për këtë. Gjithashtu, do të doja të di nëse keni planifikuar ndonjë buxhet për vitin 2026, për kryetarët e fshatrave në formë të pagesave apo subvencioneve. Një kërkesë tjetër e kam për Drejtorinë e Sportit, meqenëse po flasim për buxhet, p.sh kushtet në shkollën e futbollit "Trepça". Unë kam një fëmijë që luan atje, por aktualisht terreni është në gjendje shumë të keqe dhe është shumë i rrezikshëm që të luhet në tendë, kam parë që nuk janë bërë përmirësime prej vitesh, kjo situatë është shumë shqetësuese, pasi fëmijët janë në rrezik. E di që më herët aty ka pasur stadium, por politika e mëparshme e ka uzurpuar këtë hapësirë për qëllime personale dhe nuk është përdorur për komunitetin. Kisha dëshirë të diskutoja me kryetarin dhe me të gjithë për të gjetur një zgjidhje dhe për të bërë diçka për këta fëmijë që të mos jenë në rrezik.

Igballe Islami: Sa i përket ndërtimit të rrugëve në fshatin Koprivë, dua të theksoj se ju keni qenë vazhdimisht aktiv në dëgjimet buxhetore. Pas miratimit të buxhetit komunal, ai publikohet në faqen zyrtare të komunës, ku mund të gjeni informacion edhe për ndërtimin e rrugës në Koprivë, për të cilën është ndarë buxhet për vitin 2025. Si informatë shtesë, ndërtimi i rrugës në Koprivë ka filluar të realizohet dhe është lidhur një memorandum bashkëpunimi me Demos-in dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me mjetet që kemi fituar nga garanti i performancës. Nga pozita ime si Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa, mund t'ju siguroj që buxheti është ndarë dhe përdorimi i tij është i rregullt. Sa i përket shpenzimeve në vende të tjera, kodi i projektit i lejon ekzekutimin dhe vetëm nga thesari i Kosovës dhe vetëm në bazë të urdhërave përmbarimore ose vendimeve të gjykatave, të cilat janë plotësisht ligjore dhe jashtë ndikimit tonë. Ju ftoj të vazhdoni të jeni aktiv në këtë proces, pasi kemi edhe një bashkëfinancim nga Demosi dhe MAPL-ja për ndërtimin e rrugës në Koprivë. Pas kësaj, përgjegjësia i kalon Drejtorisë së Infrastrukturës, e cila është e detyruar të paraqesë projektet në detaje teknike dhe të ndjekë procedurat e prokurimit publik. Sa i përket pagesave për kryetarët e këshillave lokale nuk është e nevojshme të planifikohet buxhet i veçantë, sepse Komuna e Mitrovicës ka mjete të mjaftueshme në kategoritë e mallrave, shërbimeve dhe subvencioneve. Problemi kryesor qëndron tek barrierat ligjore që kemi në fuqi. Së bashku me ju dhe me Drejtorinë e Arsimit, kemi qenë në zyrë së fundmi, ku kam bërë të ditur se sapo të kemi një vendim të vlefshëm nga Zyra Ligjore e Komunës, do të ekzekutojmë pagesat brenda 48 orëve. Pra, problemi nuk është financiar, por ligjor. Komuna ka angazhim maksimal për të krijuar hapësirën ligjore që të realizohen pagesat tuaja. Në lidhje me pyetjen

për DKRS-së nuk kam njohuri të mjaftueshme për temat e parcelave apo të tjera, por besoj që drejtori i kësaj drejtorie do t'ju japë përgjigje të saktë sapo të lexojë pyetjen. Ju siguroj se me gjithë potencialin dhe bashkëpunimin me Zyrën Ligjore, jemi duke punuar për të gjetur zgjidhje ligjore që të mund të ekzekutojmë pagesat e juaja, pasi problemi nuk është mungesa e mjeteve financiare, por barrierat ligjore për procedimin e tyre.

Haxhi Salihu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Dua të falënderoj për thirrjen e këtij takimi dhe për mundësinë që kemi të diskutojmë së bashku. Kam disa kërkesa të rëndësishme lidhur me realizimin e projekteve dhe zgjidhjen e problemeve që lidhen me infrastrukturën, përfshirë rrugët dhe trotualet. Në lidhje me këto çështje, dua të theksoj se për fat të keq shumë pak gjëra janë bërë. Në fshatin tonë dhe në zonat përreth ka shumë rrugë që janë ende të pashtuara dhe me probleme serioze. Ka rrugë pa asfalt, pa kanalizime adekuate dhe uji i rrëmbyer nuk kanalizohet si duhet, kjo shkakton vështirësi dhe rrezik për banorët, përfshirë edhe gratë dhe fëmijët që kalojnë aty çdo ditë konkretisht fjala është për rrugët e lagjeve Brahimi dhe Seferi. Dua të theksoj se kjo situatë është shumë shqetësuese dhe kërkon vëmendje të menjëhershme nga autoritetet komunale dhe drejtoritë përkatëse. Për shembull, disa rrugë janë ndërtuar vetëm deri në një pjesë, ndërsa pjesa tjetër mbetet e papunuar dhe pa trotua, duke rrezikuar banorët dhe duke krijuar kushte të këqija për jetesë. Në lidhje me rrugët në lokalitetin Kushtovë, unë kam ngritur këtë çështje publikisht dhe kam kërkuar që të përfundohet ndërtimi i trotuarëve, por fatkeqësisht nuk është bërë asgjë deri tani. Një rast tragjik na ka goditur, ku në këtë zonë kanë ndodhur dy viktima për shkak të kushteve të këqija të rrugëve dhe mungesës së infrastrukturës bazë, duke përfshirë edhe mungesën e kanalizimeve dhe rrjetit elektrik të rregullt. Prandaj, i bëj thirrje drejtorit për infrastrukturë dhe autoriteteve komunale që të marrin masa urgjente për të përmirësuar këto kushte dhe për të siguruar një ambient të sigurt dhe të përshtatshëm për jetesë. Në fund, dua të shpreh zhgënjimin tim për vonesat dhe mungesën e veprimeve konkrete dhe shpresoj që së shpejti të kemi rezultate konkrete dhe të prekshme në këtë drejtim. Po ashtu të gjitha kërkesat e mia janë të drejtuara në drejtoritë përkatëse.

Igballë Islami: Pajtohem me disa pika nga diskutimi yt, por dua të theksoj që dy vitet e fundit janë bërë disa punë konkrete. P.sh. ambulanca është funksionalizuar, janë ndërtuar disa trotua dhe është zgjeruar rrjeti i ndriçimit publik. Natyrisht, ka edhe shumë punë që duhet bërë, dhe për këtë arsye kemi thirrur dëgjimin buxhetor. Unë nuk jam ajo që procedoj drejtpërdrejt projektet dhe nuk jam drejtoreshë e infrastrukturës, por mund t'ju konfirmoj që ndërtimi i rrugëve në fshatin Kushtovë është pjesë e buxhetit komunal, ashtu si edhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve, dhe për këtë ka mjete të ndara. Ju ftoj që kur të keni kohë, të vini e të diskutoni drejtpërdrejt me mua për punën në të cilën jam angazhuar, që të mund të sqarojmë çdo gjë. Sa i përket pjesës tjetër, nëse keni marrë përgjigje me shkrim apo jo, kjo është përgjegjësi e drejtorit, mirëpo është mirë që e ngrini si shqetësim, sepse është pjesë e procesverbalit dhe duhet të trajtohet në mënyrë ligjore.

Arsim Musa: Përshëndetje për të gjithë. Unë jam përfaqësues i Tunelit të Parë, dhe dua të theksoj disa çështje që lidhen me gjendjen e infrastrukturës në zonën tonë. Së pari, dua të përmend që në vitet e fundit janë bërë përparime të rëndësishme, sidomos në ndërtimin e tunelit të parë dhe në zonën e Rekës, dhe në Kutillovc. Por, ende ka punë të pakryera dhe probleme që kërkojnë zgjidhje. Ne jemi të interesuar që të dimë se sa kërkesa të banorëve janë realizuar dhe sa janë në proces. Një nga kërkesat kryesore të banorëve për vitin 2025 është rregullimi i kulmeve të banesave kolektive, ka probleme serioze me rrjedhjen e ujit nga kulmet, që shkakton dëme të mëdha e dimë që kjo ka një kosto të madhe, por është një nevojë urgjente. Kam pasur bashkëbisedime edhe me organizata të ndryshme për të mundësuar investime apo subvencione në këtë drejtim. Gjithashtu, një pjesë e trotuarëve janë dëmtuar dhe kanë nevojë për riparim. Ndriçimi në rrugën kryesore është përfunduar, por ka nevojë për mirëmbajtje dhe përmirësim në zona të tjera. Në Kutillovc kemi një fermer të vyeshtëm për bujqësi dhe rruga kryesore që shërben banorët dhe vizitorët është e qasshme dhe mirë e mirëmbajtur. Gjithashtu, hapësira e varrezave është pastruar dhe zgjeruar me përkushtim nga vetë banorët. Sa i përket ujit të pijshëm, nuk kemi

problem, dhe sistemi i kanalizimit është i mirë për momentin, pa nevojë për zgjerim të menjëhershëm. Ambulanca funksionon nga ora 7 deri në 14, me shërbime stomatologjike dhe të mjekësisë familjare. Por ka një problem, pasi ambulanca është në pronësi të Trepçës dhe jo të komunës, që ndonjëherë pengon në investime dhe përmirësime. Viti i kaluar kemi ngritur këtë çështje në bashkëpunim me drejtorin Fahri Shabani dhe kryetarin z. Bedri Hamza, për të kërkuar zgjidhje. Në fund, dua të theksoj sërish domosdoshmërinë e rregullimit të kulmeve të ndërtesave, që është një problem serioz dhe kërkon fonde dhe vëmendje të veçantë.

Igballe Islami: Faleminderit shumë për përkushtimin dhe kontributin tuaj vullnetar për Tunelin e Parë. Dua t'ju njoftoj se sa i përket projekteve që janë në proces, përgjegjësia kryesore bie mbi Drejtorinë e Infrastrukturës, pasi ata janë më të informuar për gjendjen në terren dhe bashkëpunimin me operatorët ekonomikë. Sa i përket procedurave të lidhura me Zyrën e Prokurimit, dihet se kontrata për ndriçimin publik është aktive dhe operatorët ekonomikë duhet vetëm të marrin porositë për zbatimin e punës. Në lidhje me kulmet e banesave, është diskutuar se në Komunën e Mitrovicës dhe përveç mundësisë së subvencioneve siç e cekët edhe ju, pra kjo mbetet një sfidë, sepse investimet kapitale komunale janë të dedikuara vetëm për hapësirat publike, dhe është e vështirë të ndërhyhet në pronat private. Megjithatë, çështja është marrë seriozisht në konsideratë. Sa i përket ambulancës, e cila funksionon në hapësirat e Kombinatit Trepça, është e njëjta situatë si me ambulancën në Stantërg, ku falë bisedimeve me menaxhmentin e atëhershëm u arrit marrëveshje për ndërtim. Aktualisht, edhe me menaxhmentin e ri të Trepçës janë diskutime të vazhdueshme. Komuna ka vullnet dhe mjete financiare për të ndërtuar një ambulancë të re në Tunelin e Parë, por pengesë mbetet pronësia e hapësirave. Shpresojmë që këto diskutime të përfundojnë me një zgjidhje pozitive. Unë jam në dispozicion për çdo pyetje dhe do përpiqem t'ju jap përgjigje për çështjet që janë në kompetencë të mia, ndërsa për ato që varen nga drejtoritë e tjera, besoj se do të merrni përgjigjet e nevojshme nga ata.

Jakup Gashi: Unë jam përfaqësues i fshatrave Vaganicë e Ulët dhe Vaganicë e Epërme, dhe sjell shqetësimet kryesore të banorëve dhe komunitetit tonë. Si pikë e parë e kemi shqetësimin nga qenët endacak ku nuk kemi siguri që fëmijët tanë të shkojnë në shkollë pa përcjelljen tonë, po ashtu kemi një problem me transportin e nxënësve që shkojnë në shkollë çdo mëngjes. Ky transport ka qenë i organizuar që prej vitit 2012, por prej disa muajsh ka ngecur, ndërsa kontaktet me drejtoreshën përgjegjëse kanë dhënë vetëm përgjigje se "është në proces". Kjo situatë po krijon vështirësi të mëdha për familjet tona. Së dyti, rrugët në fshatin Vaganicë e Epërme janë në gjendje shumë të keqe dhe komuna nuk ka investuar fare aty. Ndërsa në Vaganicën e Epërme ka pasur disa përpjekje për riasfaltim në pjesë të vogla prej rreth 600-700 metrash, kjo është e pamjaftueshme dhe rrugët mbeten problematike. Gjithashtu, ka një rrugë kryesore që lidh tri palë varreza, e cila është pothuajse e papërbalueshme për kalim, sidomos në dimër. Nuk kërkojmë asfaltim të plotë, por të paktën zhavor për kalueshmëri më të mirë. Në lidhje me infrastrukturën bujqësore, dua të falënderoj drejtorin e Bujqësisë për përkushtimin dhe mbështetjen në ofrimin e mjeteve bujqësore dhe për mbështetjen e serave në fshat, të cilat kanë aplikuar dhe nuk janë refuzuar. Ndriçimi publik është bërë në disa pjesë të Fshatit, por për fat të keq cilësia e dritave nuk është e kënaqshme dhe disa zona mbeten të pa ndriçuara. Në përgjithësi, ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë dhe jemi në kontakt me institucionet komunale, dhe do të vlerësojmë shumë nëse do të kishte një qasje më konkrete për investime në rrugët e fshatit, sidomos ato pranë varrezave dhe rrugë kryesore që lidhen me qendrat e banimit. A ka ndonjë projekt aktual për këto dy rrugë? Nëse po, do të ishim shumë të interesuar të marrim informacione për fazën ku ndodhen dhe planifikimet për realizimin e tyre.

Igballe Islami: Fillimisht, dua të trajtoj çështjen e qenve endacakë. Ky nuk është problem vetëm i fshatit Vaganicë, por i gjithë komunës së Mitrovicës. Gjatë vitit të kaluar, komuna kishte një kontratë aktive për trajtimin e qenve endacakë, por këtë vit ende nuk kemi një kontratë të tillë. Jemi në proces të nënshkrimit të kontratës dhe brenda afateve ligjore, kjo çështje po trajtohet në Zyrën e Prokurimit. Pra, për momentin nuk ka kontratë aktive, por besojmë se do të finalizohet së shpejti. Sa i përket transportit të nxënësve, unë jam në dijeni që për këtë punë janë kontraktuar agjencione që bëjnë transportin, por

nuk di pse për fshatin Vaganicë nuk ka transport, për këtë Drejtorja e arsimit mund të jap një përgjigje sepse nuk besoj se është një çështje financiare. Në tërë territorin e komunës, transporti funksionon normalisht dhe shpenzimet mbulohen nga komuna. Edhe ne si komunitet kemi paguar vazhdimisht për këtë shërbim. Në buxhetin e vitit 2025 dhe në planifikimin për vitin 2026, është paraparë ndërtimi i rrugëve në lagjen Vaganicë dhe në fshatin Vërnice. Drejtori i Infrastrukturës do të mund t'ju informojë më saktë për fazën ku ndodhen këto projekte, sa i përket mirëmbajtjes verore të rrugëve me zhavorr, për momentin nuk kemi një kontratë aktive, por jemi në proccs të nënshkrimit të saj. Është një kosto e vogël, por që mund të kryhet lehtë dhe do të ndihmonte shumë për kalueshmërinë e rrugëve në Fshat.

Asllan Vitaku: Unë propozoj riparimin e palestrës së Omnisportit, e cila u dëmtua rëndë pas vërshimeve, kjo palestër është një vend shumë i rëndësishëm për të rinjtë tanë, ku ata mund të angazhohen në sporte të ndryshme. Me sukseset që po arrijnë sportistët tanë, rinia meriton që ky objekt të rikthehet në funksion.

Igballe Islami: Me të vërtetë, është shumë e domosdoshme dhe e nevojshme funksionalizimi i palestrës së Omnisportit, e veçanërisht për Klubin e Notit, të cilët vazhdimisht po bëjnë kërkesa për këtë çështje. Ne e marrim këtë si një kërkesë serioze, mirëpo duhet të kemi parasysh që është një ndërmarrje e cila i nënshtrohet Ligjit për ndërmarrje publike, ligj i veçantë që kërkon planifikim të kujdesshëm të buxhetit komunal. Jemi në kohën e duhur për të planifikuar mjetet financiare, dhe njëkohësisht kemi bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, të cilat kanë arritur një marrëveshje të rëndësishme. Unë shpresoj që procedurat e prokurimit të përfundojnë brenda këtij viti, në mënyrë që kjo qendër të funksionalizohet sa më parë. Prandaj, besoj që tashmë kemi një marrëveshje konkrete dhe presim me padurim përfundimin e procedurave. Faleminderit shumë për durimin dhe vëmendjen! Gjithashtu, dua t'ju falënderoj për pyetjet dhe ju kërkoj mirëkuptim nëse për disa prej tyre nuk kam përgjigje të plota, sidomos nëse ato nuk janë në kompetencat e drejtorisë sime. Ne jemi përpjekur të jemi sa më gjithëpërfshirës dhe për pyetjet specifike kemi adresuar drejt drejtorive përkatëse, të cilat besoj do t'ju përgjigjen në mënyrë të detajuar.

Ju konfirmoj se ne jemi vetëm në fazën fillestare të planifikimit të buxhetit, dhe gjatë këtyre dy muajve kemi planifikuar të mbajmë deri në dhjetë dëgjime buxhetore me qytetarët dhe grupet e interesit, të ndara në kategori dhe lokalitete. Do të përpiqemi që këto dëgjime të mbahen në orët e pasdites, për shkak të temperaturave të larta, në mënyrë që pjesëmarrja të jetë sa më e kënaqshme. Uroj që nga këto dëgjime buxhetore të dalin kërkesa që do të mund të implementohen dhe që së bashku me punën e drejtorive të kemi realizim të suksesshëm të tyre. Jemi të vetëdijshëm që është një punë e madhe dhe sfiduese, për më tepër kur kemi përpara procedurat e prokurimit publik, të cilat janë sfida jo vetëm për Komunën e Mitrovicës, por në nivel vendi. Po ashtu, kemi sfida të tjera në aspektin ligjor, siç është rasti i pagesave të ndryshme. Por, me një aktivizëm të përbashkët të qytetarëve dhe punën institucionale, besoj fuqimisht që do të arrijmë të realizojmë shumë punë të mira për Mitrovicën.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 15:00 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Afërdita MAXHUNI

Kryesuesja e Kuvendit


Vesa BROJA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-400/01-0031545/25 Datë: 11.06.2025

KONSULTIM PUBLIK PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2026-2028

Lista e pjesëmarrjes në konsultim publik:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Datë	Nënshkrimi
1.	Haxhi Salihu	11.06.2025	[Signature]
2.	ISAK HADRI	11.06.2025	[Signature]
3.	Aslan Vitaku	11.06.2025	[Signature]
4.	JAKUP GASHI	11.06.2025	[Signature]
5.	XHEZAZIN BALIU	11.06.2025	[Signature]
6.	RESIM MOJA	11.06.2025	[Signature]
7.	ERMIRA GASHI	11.06.2025	[Signature]
8.	Artesa Shaziraj	11.06.2025	[Signature]
9.	Ajla Musa	11.06.2025	[Signature]
10.	Eliza Baliu	11.06.2025	[Signature]
11.	Enes Ramo	11.06.2025	[Signature]
12.	Feride Katalu	11.06.2025	[Signature]
13.	Ahmeti Beqani	11.06.2025	[Signature]
14.	KEKELI ISPAHANI	11.06.2025	[Signature]
15.	RAZMI JASHARI	11.06.2025	[Signature]
16.	Hferdita Markoni	11.06.2025	[Signature]
17.	Arjana Rustedi	11.06.2025	[Signature]
18.		11.06.2025	
19.		11.06.2025	
20.		11.06.2025	
21.		11.06.2025	
22.		11.06.2025	
23.		11.06.2025	
24.		11.06.2025	
25.		11.06.2025	
26.		11.06.2025	
27.		11.06.2025	
28.		11.06.2025	
29.		11.06.2025	
30.		11.06.2025	
31.		11.06.2025	
32.		11.06.2025	
33.		11.06.2025	
34.		11.06.2025	
35.		11.06.2025	
36.		11.06.2025	
37.		11.06.2025	
38.		11.06.2025	
39.		11.06.2025	